

GAZETARIA LOKALE NË RREZIK:


Liria e mediave,
dinamikat e
kushtëzuara gjinore
dhe rezistenca
demokratike



LE GOUVERNEMENT
DU GRAND-DUCHÉ DE LUXEMBOURG
Ministère des Affaires étrangères
et européennes
Direction des affaires européennes et
des relations économiques internationales

Gazetaria lokale në rrezik:

Liria e mediave, dinamikat e kushtëzuara
gjinore dhe rezistenca demokratike



Titulli: Gazetaria lokale në rrezik: Liria e mediave, dinamikat e kushtëzuara gjinore dhe rezistenca demokratike

Titulli i origjinalit: Local Journalism at Risk: Media Freedom, Gendered Dynamics and Democratic Resilience

Botuesi: Reactor – Kërkim në Veprim

Redaktore: Tanja Ivanova dhe Marija Bashevaska

Autore: Dushica Lazova dhe Jana Dimitrova

Përkthyer nga anglishtja nga: Jetmir Ziba

Dizajni Grafik: Kristina Atanasova

Shkup, 2026

Kopje Falas / Jo-komerciale

CIP - Katalogizacija vo publikacija
Nacionalna i univerzitetska biblioteka "Св. Климент Охридски", Скопје

338+349.2:070(497.7-21)(047.31)

305:070(497.7-21)(047.31)

070.13:34(4-672EУ:497.7)(047.31)

LAZOVA, Dushica

Gazetaria lokale në rrezik : liria e mediave, dinamikat e kushtëzuara gjinore dhe rezistenca demokratike / [autore Dushica Lazova dhe Jana Dimitrova ; përkthyer nga anglishtja nga Jetmir Ziba]. - Shkup : Reactor – Kërkim në Veprim, 2026. - 64 стр. ; 23 см

Превод на делото: Local journalism at risk : media freedom, gendered dynamics and democratic resilience. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4684-64-0

1. Dimitrova, Jana [автор]

а) Локално новинарство -- Социоекономски услови -- Македонија -- Истражувања б) Локално новинарство -- Родови динамики -- Македонија -- Истражувања в) Слобода на медиумите -- Правна рамка -- Европска Унија -- Македонија -- Истражувања

COBISS.MK-ID 68352261

Ky material është financuar plotësisht ose pjesërisht nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Evropiane, Mbrojtjes, Bashkëpunimit për Zhvillim dhe Tregtisë së Jashtme të Luksemburgut, e cila nuk i ndan domosdoshmërisht pikëpamjet e shprehura këtu. Autorja është përgjegjëse e vetme për përmbajtjen.

Përmbajtja

Hyrje	6
Pozicionimi i hulumtimit dhe qëllimet kryesore:	10
Sjellja e fokusit lokal	
Deklarata e pajtueshmërisë metodologjike dhe etike	11
Qasja e hulumtimit	12
a. Parimet metodologjike	13
b. Mbledhja e të dhënave dytësore	14
c. Mbledhja e të dhënave parësore	14
d. Kufizimet e studimit dhe rrugët për hulumtime të ardhshme	14
Kuadri ligjore	18
Korniza ndërkombëtare	19
Korniza nacionale	21
Analiza e kontekstit dhe gjetjet	27
Të drejtat e punës dhe kushtet socio-ekonomike	27
Liria e mediave dhe siguria e gazetarëve lokalë	32
Mbrojtja, sindikalizimi dhe solidariteti	47
Vështrim përpara: Gazetaria lokale midis autonomisë, kufizimit dhe mundësisë	52
Rekomandime	56

HYRJE



Sipas raportit të fundit të Reporterëve pa kufi (RSF), gazetarët në Maqedoninë e Veriut nuk përballen me një mjedis armiqësor sistematik; megjithatë **ndikimi politik, dezinformimi dhe zhvlerësimi në rritje i profesionit** vazhdojnë të minojnë kapacitetin e tyre për raportim të pavarur, të thelluar dhe për të gërryer besimin e publikut në media.¹ Mediat e pavarura dhe lokale janë veçanërisht të cënuara ndaj kërcënimeve, frikësimeve dhe presionit ekonomik, ndërsa zyrtarët qeveritarë shpesh shfaqin qëndrime përçmuese ose armiqësore ndaj gazetarëve² - kushte që mund të ndjehen më së shumti jashtë kryeqytetit, ku resurset janë të pakta dhe afërsia me pushtetin është e pashmangshme.

Në një klimë të tillë, **funksioni demokratik i medias si mbikëqyrës civil – për të mbikëqyruar** me kujdes pushtetin, për të siguruar transparencë në administratën publike dhe për t'i dhënë dukshmëri padrejtësive që prekin jetën e njerëzve – bëhet gjithnjë e më i vështirë për t'u mbështetur. Kur institucionet dobësohen nga korrupsioni³ dhe vetë sektori i medias karakterizohet nga kushte të pasigurta pune, pavarësia⁴ e plotë e redaksisë mund të duket si një ideal i largët. Megjithatë, pikërisht në këto kufizime gazetaria ruan qëllimin e saj më thelbësor demokratik: **ndriçimin e keqpërdorimeve të pushtetit në emër të së vërtetës dhe llogaridhënies publike dhe ruajtjen e rezistencës demokratike në nivel komuniteti.**⁵

Ky rol është veçanërisht jetik në kontekstet ku korrupsioni nuk është një problem i qeverisjes abstrakte, por një realitet i jetuar që formon ndërveprimet e përditshme midis qytetarëve dhe institucioneve. **Korrupsioni mbetet një sfidë kritike për Maqedoninë e Veriut.** Sipas Indeksit për perceptim të korrupsionit (CPI) të vitit 2024 të Transparency International, shteti renditet në vendin e 88-të nga 180, me një rezultat 40/100, duke shënuar një rënie prej 12 vendesh në krahasim me vitin e kaluar.⁶ Vlerësimet e fundit tregojnë më tej se një në tre qytetarë në Maqedoninë e Veriut ka paguar një formë rryshfeti për të përfunduar një detyrë administrative, duke reflektuar shkallën në të cilën korrupsioni përshkon jetën e përditshme.⁷ Vetëm raportimi i qëndrueshëm dhe i pavarur mund të ekspozojë praktikën e fshehura që mbështesin korrupsionin, megjithatë një raportim i tillë varet nga një mjedis mediatik që mbron autonominë e redaksisë, qasjen në informacione dhe mbrojtjen nga presionet politike dhe ekonomike.⁸ Urgjenca e kësaj nevoje u ekspozua tragjikisht në mars të vitit 2025 kur një zjarr piroteknik shpërtheu në klubin e natës Pulse në Koçan, duke vrarë 63 vetë dhe duke plagosur shumë të tjerë.⁹ Hetimet e mëvonshme zbuluan një zinxhir mosveprimesh dhe veprimesh të paligjshme nga nëpunësit zyrtarë, duke përfshirë mungesën e pajtueshmërisë me sigurinë, mungesën e licencimit të

¹ Reporterët pa kufi: Maqedonia e Veriut. <https://rsf.org/en/country/north-macedonia>

² ibid.

³ Ristovska, J., Cvetanovska, T. & Trpovska, S. (2025). *Raporti i vlerësimit të korrupsionit për Maqedoninë e Veriut 2025. Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/bp8drpch> më 23 dhjetor 2025

⁴ Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksi për sigurinë e gazetarëve 2024* [„Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на безбедноста на новинарите 2024“]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpntuu> më 15 dhjetor 2025

⁵ Bondarenko, O.S, Utkina, M.S. & Kolesnikova, MV (2021). “The Role of Mass Media in Preventing Corruption”. *The Law, State and Telecommunications Review*, 13(1), pp. 70-93. Marrë nga: <https://tinyurl.com/msuhzajj> më 15 dhjetor 2025

⁶ Transparency International Corruption Perceptions Index: North Macedonia. Retrieved from: <https://tinyurl.com/5n8csrcs> on December 15, 2025.

⁷ Ristovska, J., Cvetanovska, T. & Trpovska, S. (2025). *Raporti i vlerësimit të korrupsionit për Maqedoninë e Veriut 2025. Qendra maqedonase për bashkëpunim ndërkombëtar*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/bp8drpch> më 23 dhjetor 2025

⁸ Rana, M. P. (2013). “Krimi i organizuar dhe korrupsioni: Një analizë teorike dhe empirike”, Universiteti i Calgary. Marrë nga: <https://tinyurl.com/mr8bktsp> më 15 dhjetor, 2025.

⁹ Smith, H. (Mars, 2025). “Zjarri në klubin e natës në Maqedoninë e Veriut vret 59 dhe të më shumë se 100 të plagosur”, [online] *The Guardian*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/mr8bktsp> më 15 dhjetor, 2025

vlefshëm dhe korrupsionin në funksionimin e vendit të ngjarjes.¹⁰ Tragjedia shkaktoi zi mbarëkombëtare dhe protesta anti-korrupsion, pasi qytetarët kërkojnë llogaridhënie.¹¹ Në muajt që pasuan, gazetarët (lokalë) u treguan jetikë në **raportimin dhe zbulimin e shtresave të klientelizmit lokal, dështimit rregullator dhe neglizhencës institucionale** që përndryshe mund të kishin mbetur të padukshme.¹²

Korrupsioni dhe krimi i organizuar janë të ndërthurura në thelb, duke vepruar përmes rrjeteve që maksimizojnë përfitimet personale ose politike duke minimizuar llogaridhënien.¹³ **Gazetaria hulmuese dhe analitike luajnë një rol kritik në ekspozimin e këtyre rrjeteve.** Puna e tyre shkon përtej raportimit të përditshëm: ajo përfshin gjurmimin e praktikave të fshehura, kontekstualizimin e skemave komplekse dhe sigurimin e publikut me informacionin e nevojshëm për të kërkuar veprim institucional.¹⁴

Në të njëjtën kohë, gazetaria vepron në kuadër të një mjedisi informacioni gjithnjë e më të ndotur nga dezinformimi. **Ngopja e narrativave anti-demokratike,** duke përfshirë fushatat anti-perëndimore dhe anti-BE, destabilizon më tej besimin e publikut dhe komplikon punën e mediave të besueshme.¹⁵ Në një kontekst ku gënjeshtat qarkullojnë më shpejt se informacioni i verifikuar, ku edukimi mediatik mbetet i ulët dhe fushatat e koordinuara të dezinformimit zbehin vijën midis propagandës dhe lajmeve, gazetaria e pavarur dhe kritike bëhet e domosdoshme.^{16 17} Këto dinamika janë veçanërisht të rëndësishme për **gjeneratat e reja,** të cilët kryesisht konsumojnë lajme përmes mediave sociale (influencuesve) dhe platformave digjitale, kusensacionalizmi, amplifikimi algoritmik dhe përmbajtja e paguar shpesh zëvendësojnë raportimin e verifikuar, respektivisht ato shiten si “fakte”.¹⁸ Këto presione amplifikohen më tej jashtë kryeqytetit. **Gazetaria lokale vepron në një ekosistem ku afërsia me aktorët politikë, të biznesit dhe institucionalë është më e madhe, ndërsa resurset janë shumë më të kufizuara.** Shumë mediave lokale u mungon stabiliteti financiar, autonomia redaktuese dhe stafi i nevojshëm për të vepruar në mënyrë të qëndrueshme, e lëre më për të ndjekur raportimin mbi korrupsionin, krimin

¹⁰ Trajkovska, M. (2025) “Zjarri i Koçanit dhe kolapsi sistematik i Maqedonisë së Veriut”, Instituti për diversitetin e medias. Marrë nga: <https://tinyurl.com/39muh4ky> në 15 dhjetor, 2025

¹¹ Dimoski, A. (2025). “Protestuesit kërkojnë ndryshim sistematik, drejtësi pas tragjedisë së Koçanit”, [online] MIA News. Marrë nga: <https://tinyurl.com/yeufjrja> më 15 dhjetor 2025

¹² Laboratorët e raportimit investigativ (2025). “Zjarri i Koçanit – Pas Flakëve”. [Video] YouTube. Marrë nga: <https://www.youtube.com/watch?v=DwbWj1qqzeo> më 15 dhjetor 2025; Përmes dokumenteve të papublikuara të hetimit, videoja e bërë nga organizata e pavarur e medias zbuloi abuzimin e pushtetit të bërë nga inspektorët, prokurorët dhe politikanët. Dy muaj pas lirimit, dy inspektorët e Drejtorisë për të ardhurat publike të ekspozuar në dokumentar u arrestuan dhe tani janë nën hetim për ryshfet dhe keqpërdorim të detyrës.

¹³ Ballegooij, W., Zandstra, T. (2016). “Organised Crime and Corruption: Cost of Non-Europe Report”, *European Parliamentary Research Service*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/3x9re6xu> më 24 dhjetor 2025

¹⁴ Schauseil, W., Zúñiga, N. & Jackson, D. (2019). “Media dhe antikorrupsioni”, *Transparency International*. Marrë nga: <http://www.jstor.com/stable/resrep20465> më 15 dhjetor 2025

¹⁵ Metamorphosis (2024). *Trendet dhe narrativat e dezinformimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor: Raporti për monitorim të medias* (tetor – dhjetor 2024). Marrë nga: <https://tinyurl.com/y3csauan> në 15 dhjetor, 2025.

¹⁶ Tuneva, M. (2024). *Ndërmjet sfidave dhe zgjidhjeve: Udhëzues për integritetin e mediave në Maqedoninë e Veriut* [„Meçy предизвиците и решенијата: Водич за интегритет на медиумите во Северна Македонија“]. UNDP. Retrieved from: <https://tinyurl.com/dr9s5bun> në 15 dhjetor, 2025

¹⁷ Serafimovska, E. & Trajkoska J. (2023). *Cënueshmëria ndaj dezinformimit midis grupeve të ndryshme të qytetarëve në Maqedoninë e Veriut* [„Панливост на дезинформации кај различни групи граѓани во Северна Македонија“]. Instituti për studime të komunikimit. Marrë nga: <https://tinyurl.com/ms9ux2ud> në 15 dhjetor, 2025

¹⁸ Popovska, V. (2021). *Ndikimi i mediave masive sociale në krijimin e opinionit publik dhe pasojat e tij të shprehura përmes ndërtimit të stereotipeve, diskriminimit, ngacmimit dhe gjuhës së urrejtjes në mesin e nxënësve të shkollave të mesme* [“Влијанието на социјалните i на медиумите во креирањето на јавното мислење и последиците од него изразени пред градеет, стереотипи, дискриминација, булинг i говор на омраза кај средношколиците”], Instituti për të drejtat e njeriut. Marrë nga: <https://tinyurl.com/4yupe5sw> në 15 dhjetor, 2025

e organizuar ose abuzimin me pushtetin.¹⁹ Kjo tendosje ekonomike përkon me erozionin e vazhdueshëm të gazetarisë lokale, duke lënë pjesë të mëdha të vendit pa lajme të rregullta dhe të besueshme për komunitetet e tyre. Ndërsa rrjetet e korrespondentëve dikur përbënin shtyllën kurrizore të raportimit nacional, tani ato janë reduktuar në një prani simbolike të disa korrespondentëve të punësuar plotësisht dhe disa korrespondentëve të pavarur.²⁰

Si rezultat, **tregimet lokale rrallëherë hyjnë në sferën publike nacionale**, duke mundësuar paqartësi politike, korrupsion të pakontrolluar dhe pothuajse padukshmëri të çështjeve të përditshme me të cilat përballen qytetarët jashtë kryeqytetit. Në mjediset e tilla, ku afërsia ushqen familjaritet dhe varësi, gazetarët përballen me presion joformal, sulme reputacioni dhe rreziqe të drejtpërdrejta kur mbulojnë korrupsionin ose keqpërdorimin e resurseve publike.

Këto presione nuk përjetohe në mënyrë të barabartë: ato kryqëzohen me pasigurinë e punës, gjeografinë dhe gjininë, duke prodhuar rreziqe dhe cënueshmëri të diferencuara, veçanërisht për gratë gazetare që punojnë në mjediset e mediave lokale.²¹ Prandaj, gratë gazetare duhet të përballen jo vetëm në hakmarrjen profesionale, por edhe në ngacmimin dhe diskriminimin gjinor, një model i vërejtur gjerësisht në vlerësimet ndërkombëtare dhe nacionale të lirisë së medias.^{22 23}

Pavarësisht rolit të tyre vendimtar demokratik, gazetarët lokalë që punojnë jashtë kryeqytetit mbeten kryesisht jo të përfshirë nga hulumtimet, debatet e politikave dhe programet e zhvillimit të medias. Duke e njohur këtë **hendek të njohurive** si thelbësor për të kuptuar lirinë e medias dhe shpërndarjen e pushtetit në Maqedoninë e Veriut, ky hulumtim shqyrton përvojat, dobësitë dhe dinamikat gjinore që formësojnë gazetarinë lokale sot.

¹⁹ Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksi për sigurinë e gazetarëve 2024* [„Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на безбедноста на новинарите 2024“]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpptuu> më 15 dhjetor 2025.

²⁰ Koka, F. (2021). *Situata me korrespondentët në RTM* [„Состојба со дописниците на МРТ“]. SHGM. Marrë nga: <https://tinyurl.com/5n6zkbxk> më 15 dhjetor 2025.

²¹ Janevska, U. (2024) “Gratë gazetare nga mediat lokale nën një ortek diskreditimesh” [„Новинарките од локалните медиуми под канонада дискредитации“]. [online] PINA.mk. Marrë nga: <https://tinyurl.com/5n7amwtu> më 15 dhjetor 2025

Posetti, J. et al. (2022) *The Chilling: Studimi global i gazetarëve për dhunën online ndaj grave Qendra ndërkombëtare për gazetarët*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/47vbtma> më 15 dhjetor 2025.

²² Spirovski, M & Todorovska-Kostovska, V. (2025) *Sfidat dhe zhvillimet: Siguria e grave gazetare në Maqedoninë e Veriut 2024*. [„Предизвици и напредок: Безбедноста на новинарките во Северна Македонија 2024“]. *Safejournalists.net*. Është marrë nga: <https://tinyurl.com/2t38zp5t> më 15 dhjetor 2025.

Pozicionimi i hulumtimit dhe qëllimet kryesore: Sjellja e fokusit lokal

Vendimi për të zhvendosur fokusin analitik në nivelin lokal, duke integruar një perspektivë me përgjegjësi gjinore, pjesëmarrëse, ka rezultuar në hulumtime që kontribuojnë në njohuri të reja, specifike për kontekstin në studimet ekzistuese mbi lirinë e medias dhe sigurinë e gazetarëve në Maqedoninë e Veriut. Ndërsa hulumtimet e mëparshme përqendrohen kryesisht në mediat nacionale, kornizat ligjore zyrtare ose incidentet e izoluara të ngacmimit, ky studim shqyrton se si pasiguria strukturore, presioni politik dhe dinamika gjinore ndërthuren në jetën e përditshme të punës së gazetarëve lokalë.

Duke **paraprirë betejat e përditshme të gazetarëve jashtë kryeqytetit**, hulumtimi zbulon se si varësia ekonomike, marrëdhëniet joformale të pushtetit dhe mbrojtja e dobët institucionale formojnë si vendimmarrjen e redaksisë ashtu edhe rrezikun personal. Ai demonstroi **se kushtet e punës, shqetësimet e sigurisë, gjinia dhe dezinformimi** nuk mund të trajtohen si çështje të ndara, por si **faktorë përforcues** të ndërsjellë që minojnë gazetarinë lokale dhe qëndrueshmërinë e saj dhe lidhjen me audiencat e reja dhe punëtorët e ardhshëm të medias. Duke vepruar kështu, ai plotëson një zbrazëtim kritik në bazën e dëshmive dhe ofron njohuri të bazuara për ndërhyrje më të synuara, të ndjeshme ndaj kontekstit që synojnë përforcimin e lirisë së medias, barazisë gjinore dhe llogaridhënies demokratike në nivel lokal.

Prandaj, ky studim kërkon të:

- Njiheni me përvojat, nevojat dhe prioritetet e grupeve të synuara përfituese (gazetarët lokalë, veçanërisht gratë).
- Përcaktoni format e pasigurisë dhe presioneve profesionale, si dhe ngacmimet, kërcënimet dhe diskriminimet (me bazë gjinore) me të cilat përballen gazetarët lokalë, veçanërisht kur raportojnë për korrupsionin, qeverisjen, krimin dhe të drejtat e njeriut.
- Identifikoni sfidat dhe kufizimet e kapaciteteve të redaksive (teknike, finansiare dhe menaxheriale) dhe se si ato ndikojnë në cilësinë, pavarësinë dhe qëndrueshmërinë e gazetarisë lokale.
- Hetoni se si gazetarët lokalë reagojnë ndaj ngacmimeve, presionit dhe mangësisë institucionale, duke përfshirë mbështetjen në rrjetet e kolegëve, solidaritetin joformal dhe mekanizmat e përballimit.
- Analizoni politikatat dhe kornizat rregullatore të zbatueshme për mediat lokale dhe identifikoni boshllëqet dhe mundësitë për përmirësimin e kushteve të punës, sigurisë, pavarësisë redaktuese dhe barazisë gjinore në gazetarinë lokale.
- Përcaktoni perspektivat dhe prioritetet e aktorëve kryesorë në ekosistemin e medias, duke përfshirë redaktorët, pronarët e medias, sindikatat dhe shoqërinë civile dhe aktorët institucionalë, në lidhje me mbështetjen për gazetarinë (lokale) dhe barazinë gjinore në sektor.
- Shqyrtoni se si kornizat ligjore, mekanizmat institucionalë dhe sindikatat profesionale, siç janë Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatik (SPGPM) dhe Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë së Veriut (SHGM), përjetohen nga gazetarët, qasja e tyre dhe roli i domosdoshëm në mbrojtjen e të drejtave dhe sigurisë së gazetarëve.

Në përgjithësi, kjo analizë shkon përtej pajtueshmërisë formale për të shqyrtuar se si boshllëqet rregullatore, zbatimi i pabarabartë dhe realitetet e nivelit lokal krijojnë boshllëqe strukturore dhe pika hyrëse të pashfrytëzuara për përmirësimin e sigurisë, përforcimin e mbrojtjes, pavarësinë redaktuese dhe reformat e punës me përgjegjësi gjinore.

Deklarata e pajtueshmërisë metodologjike dhe etike

Ky studim u krye në përputhje të plotë me standardet e njohura të integritetit etik, metodologjik dhe hulumtues, veçanërisht në dritën e kontekstit politikisht të ndjeshëm dhe me rrezik të lartë në të cilin veprojnë gazetarët në Maqedoninë e Veriut.

Dizajni i hulumtimit kombinoi të dhënat parësore cilësore (intervista të thelluara, konsultime dhe angazhim pjesëmarrës) me një rishikim sistematik të burimeve dytësore, duke përfshirë kornizat ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, dokumentet e politikave, raportet e monitorimit dhe studimet paraprake empirike. Mbledhja e të dhënave parësore ndoqi parimet e hulumtimit feminist dhe pjesëmarrës, duke i dhënë përparësi pëlqimit të informuar, konfidencialitetit, minimizimit të rrezikut dhe sigurisë së pjesëmarrësve, veçanërisht gazetarëve që punojnë në komunitete të vogla ku anonimiteti është në thelb i brishtë.

Të gjithë të intervistuarit morën pjesë vullnetarisht dhe u informuan për qëllimin e hulumtimit, përdorimin e synuar të gjetjeve dhe të drejtën e tyre për të tërhequr ose kufizuar zbulimin në çdo moment. Asnjë informacion personalisht i identifikueshëm nuk zbulohet dhe citimet janë anonime për të parandaluar identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, përveç nëse është dhënë pëlqimi ndryshe. Vendimet në lidhje me përfshirjen e të dhënave u udhëhoqën nga një parim parandalues, duke i dhënë përparësi sigurisë së pjesëmarrësve mbi plotësinë e raportimit.

Pretendimet analitike bazohen ose në materialin origjinal empirik të gjeneruar përmes këtij studimi ose në burime dytësore të identifikueshme qartë, duke përfshirë organet e njohura ndërkombëtare të monitorimit, institucionet nacionale dhe organizatat profesionale. Kur ofrohet analizë kontekstuale ose historike, ajo pasqyron të dhëna publike të dokumentuara mirë dhe vlerësime të pranuar gjerësisht, me referenca të qarta të përfshira për të siguruar transparencë dhe gjurmueshmëri.

Ekipi hulumtues zbatoi refleksivitet të vazhdueshëm gjatë gjithë procesit, duke vlerësuar në mënyrë kritike pozicionin, marrëdhëniet e pushtetit dhe ndikimet e mundshme të vetë hulumtimit mbi pjesëmarrësit dhe ekosistemin e medias. Kjo qasje synonte të shmangte praktikatat nxjerrëse dhe të siguronte që studimi të kontribuonte me përgjegjësi në përfaqësimin e bazuar në dëshmi, dialogun e politikave dhe përpjekjet për zhvillimin e medias.

Studimi nuk përmban materiale të plagjiaturës. Të gjitha burimet janë referuar në mënyrë të përshtatshme dhe analiza origjinale dallohet qartë nga punimi i cituar. Çdo kufizim i identifikuar pranohet në mënyrë transparente në raport, së bashku me rekomandimet për hulumtime të ardhshme.

QASJA E HULUMTIMIT



a. Parimet metodologjike

Ky hulumtim u krye në një mjedis mediatik politikisht të ndjeshëm dhe të pasigurt, ku gazetarët, veçanërisht në nivel lokal, përballen me rreziqe të rritura në lidhje me ngacmimin, pasigurinë e punës dhe presionin institucional, siç do të shtjellohet më poshtë. Në këtë kontekst, **parimet metodologjike pjesëmarrëse dhe feministe** u treguan thelbësore dhe jo opsionale. Ata formuan theksin e studimit në bashkë-krijimin, pronësinë e përbashkët dhe kujdesin, ndërsa reflektiviteti dhe përgjegjësia kolektive u bënë thelbësore për t'u përballur me rrezikun, pabarazitë e pushtetit dhe besimin gjatë gjithë procesit të hulumtimit.

Hulumtimi pjesëmarrës aspiron të transformojë se kush prodhon njohuri dhe pse, ndërsa praktika pjesëmarrëse feministe angazhon ata që preken më shumë nga pabarazia si bashkë-kërkues.²⁴ Prandaj, në vend që t'i trajtojmë gazetarët vetëm si subjekte të hulumtimit, **ne angazhuam gazetarë dhe ekspertë të medias në formësimin e mjeteve hulumtuese, rafinimin e udhëzuesve të intervistave dhe kontekstualizimin e gjetjeve.** Kjo shtoi një nivel të kërkimit pjesëmarrës dhe bazoi hulumtimin në realitetet profesionale të jetuara, të përshtatura me rreziqet dhe kufizimet me të cilat përballen pjesëmarrësit, veçanërisht në komunitetet e vogla ku anonimiteti është i brishtë dhe pasojat janë të menjëhershme.

Gjatë gjithë kohës, reflektiviteti u trajtua jo si një hap metodologjik diskret, por si një praktikë e vazhdueshme etike dhe politike, e cila njeh pozicionimin e vetë studiuesve dhe vë në pikëpyetje se si vetë hulumtimi mund të riprodhojë privilegje ose shtypje. Kjo flet për idenë e Scott-Villiers për **“reflektim në veprim”**: të mësuarit gjatë të bërit dhe të qëndruarit përgjegjës ndaj atyre, rreziqet e të cilëve tejkalojnë ato të vetë hulumtuesit.²⁵ Duke pasur parasysh këtë, dhe në përputhje me epistemologjitë feministe që theksojnë njohuritë e vendosura dhe ndërëgjegjësimin për fuqinë,^{26 27} ne i kemi kushtuar vëmendje të qëllimshme mënyrës se si pyetjet, formatet dhe rezultatet mund të riprodhojnë pa dashje dinamikën nxjerrëse ose t'i ekspozojnë pjesëmarrësit ndaj dëmit. Ndërtimi i besimit nënkuptonte ngadalësimin e ritmit, përshtatjen e metodave të kërkimit ndërsa hetimi evoluoi, bashkë-krijimin e mjeteve me gazetarët dhe pranimin se disa histori do të mbeteshin jo të plota. Për shembull, kemi vendosur që herët **t'i japim përparësi konfidencialitetit mbi plotësinë dhe sigurisë mbi “pasurinë” e të dhënave dhe t'u lejojmë pjesëmarrësve të vendosin kufij rreth asaj që mund të ndahet.** Reflektiviteti kërkon njohjen e kufijve të mbikëqyrjes dhe se si ndjekja e “gjetjeve gjithëpërfshirëse” mund të riprodhojë dinamikën nxjerrëse.²⁸

Ne gjithashtu e pranojmë se **vetë pjesëmarrja shpaloset në kuadër të sistemeve të pabarabarta të pushtetit.** Ndërsa qasjet pjesëmarrëse kërkojnë të demokratizojnë prodhimin e njohurive, ato nuk neutralizojnë automatikisht pabarazitë strukturorenë

²⁴ Cornwall, A. (2008). “Ç’paketimi i pjesëmarrjes’: Modele, kuptime dhe praktika.” *Revista e zhvillimit të komunitetit*, 43(3), f. 269–283.

²⁵ Scott-Villiers, P. (2021). “Reflektiviteti dhe reflektimi në kërkimin e veprimt.” Në D. Burns, J. Howard & S. Ospina (eds.), *Doracak* SAGE i hulumtimit dhe hetimit me pjesëmarrje. Londër: SAGE, f. 323–338.

²⁶ Haraway, D. (1988). “Njohuritë e vendosura: Pyetja shkencore në feminizëm dhe privilegji i perspektivës së pjesshme”. *Studime Feministe*, 14(3), f. 575–599.

²⁷ Harding, S. (1991). *Whose Science? Whose Knowledge? Thinking from Women's Lives*. Ithaca, NY: Cornell University Press.

²⁸ *ibid.*

lidhje me gjininë, statusin profesional ose vendndodhjen gjeografike.²⁹ Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e mediave lokale, ku zvogëlimi i redaksive, marrëveshjet joformale të punës dhe mungesa e mbështetjes institucionale kufizojnë aftësinë e gazetarëve për të reflektuar hapur mbi diskriminimin, ngacmimin ose presionin redaktues. Prandaj, praktika refleksive përfshinte ndjekjen e heshtjeve, hezitimeve dhe kontradiktave si të dhëna kuptimplota, në vend që t'i trajtonte ato si boshllëqe që duheshin korrigjuar.

Gjetjet nga analiza dytësore e të dhënave, intervistat e ekspertëve dhe puna e hershme në terren informuan fazat e mëvonshme të hulumtimit, duke lejuar që studimi të përsosë fokusin e tij në pasigurinë dhe heshtjen e gazetarisë lokale dhe dinamikën themelore gjinore. Kështu, procesi i hulumtimit mori parasysh rreziqet në zhvillim, duke zhvendosur dinamikën politike dhe nevojat e pjesëmarrësve, duke ruajtur ashpërsinë analitike. Së fundi, mbajtja e reflektivitetit si një angazhim etik dhe politik në punën tonë na ka ndihmuar që jo vetëm të dokumentojmë kufizimet mbi lirinë e medias dhe barazinë gjinore, por të shmangim riprodhimin e tyre në proces.

b. Mbledhja e të dhënave dytësore

Të dhënat dytësore u mblodhën dhe u analizuan për të siguruar kuptim kontekstual dhe për të informuar hartimin e mjeteve kryesore të hulumtimit. Kjo fazë përfshiu **një shqyrtim të gjërë të literaturës ekzistuese, raporteve, dokumenteve të politikave dhe hulumtimeve në lidhje me lirinë e medias, kushtet e punës, sigurinë e gazetarëve dhe dhunën me bazë gjinore në sektorin e medias**, si dhe edukimin mediatik, dezinformimin dhe besimin e publikut në media. Ne gjithashtu shqyrtaam legjislacionin nacional dhe ndërkombëtar që synon gazetarët dhe punëtorët e medias. Qëllimi ishte sistemimi i njohurive ekzistuese, identifikimi i narrativave mbizotëruese dhe hartimi i boshllëqeve që ky hulumtim mund të adresojë në mënyrë domethënëse, në vend që të dyfishojë punën e mëparshme.

Shqyrtimi konfirmoi se ekziston një hulumtim i konsiderueshëm mbi lirinë e medias, kushtet e punës së gazetarëve dhe ngacmimin në internet në Maqedoninë e Veriut. Megjithëse të marra së bashku ato ofrojnë analiza të vlefshme kontekstuale, ende mbetet **një mungesë e integritetit të plotë të perspektivës gjinore në pasigurinë e punës, marrëdhëniet e pushtetit në redaksi ose format më të gjera të heshtjes profesionale**. Në të njëjtën kohë, shumë studime që shqyrtojnë kushtet e punës ose sigurinë e medias nuk i ndajnë të dhënat sipas gjinisë ose nuk arrijnë të eksplorojnë se si gjinia formon ekspozimin ndaj rrezikut, qasjen në mekanizmat mbrojtës dhe strategjitë e përballimit.

Një tjetër boshllëk i rëndësishëm i identifikuar përmes shqyrtimit ka të bëjë me lokalizimin. Hulumtimi ekzistues përqendrohet kryesisht në mediat nacionale ose gazetarët me qendër në kryeqytet, duke ofruar **pak njohuri për realitetet e gazetarisë lokale**. Si rezultat, prevalenca, format dhe nxitësit e ngacmimit, presionit dhe heshtjes jashtë qendrave kryesore të medias mbeten të paeksploruara, ashtu si edhe roli i

²⁹ Burns, D., Howard, J. & Ospina, S. (2021). "Challenges in the Practice of Participatory Research and Inquiry." Në D. Burns, J. Howard & S. Ospina (eds.). *The SAGE Handbook of Participatory Research and Inquiry*. London: SAGE, pp. 17–33.

pasigurisë socio-ekonomike në formësimin e cënueshmërisë së gazetarëve. Kjo ngre pyetje të pazgjidhura nëse rreziqet me bazë gjinore manifestohen ndryshe në nivel lokal dhe se si resurset e kufizuara, distanca institucionale dhe strukturat informale të pushtetit ndikojnë në sigurinë dhe autonominë e gazetarëve.

c. Mbledhja e të dhënave parësore

Në përgjigje të boshllëqeve të lartpërmendura, **analiza dytësore e të dhënave u plotësua nga një eksplorim cilësor më i thelluar, duke përfshirë intervistat kryesore të ekspertëve dhe hartëzimin e palëve të interesuara**, të cilat ndihmuan në përsosjen e pyetjeve hulumtuese dhe sigurimin që hulumtimi parësor do të kapte nuanca që nuk janë të dukshme në të dhënat ekzistuese. Së bashku, këto metoda lejuan që studimi të lëvizë përtej llogarive përshkruese dhe drejt një kuptimi më të bazuar se si ndërthuren gjinia, kushtet e punës dhe liria e medias në kontekstet lokale.

Intervista të thelluara

Në total, u zhvilluan **20 intervista të thelluara: 16 intervista me gazetarë dhe/ose redaktorë lokalë dhe 4 intervista me kryeredaktorët me qendër në Shkup**. Për të siguruar përbërjen etnike gjithëpërfshirëse të mostrës, dy gazetarë dhe një kryeredaktor janë me përkatësi etnike shqiptare.

Intervistat me gazetarët/redaktorët lokalë përfshinin 11 gra dhe 5 burra. Ky raport gjinor ishte i qëllimshëm në mënyrë që të kishte terren të mjaftueshëm për të krahasuar përvojat dhe perceptimet midis gazetarëve burra dhe gra, duke ruajtur një fokus parësor në perspektivat e grave. Pjesëmarrësit vijnë nga të 8 rajonet statistikore në vend, në 13 qytete. Mostra e pjesëmarrësve përfshinte gazetarë të rinj, të mesëm të karrierës dhe të lartë me vite të ndryshme përvoja në këtë fushë. Të gjithë ata punojnë ose në media të pavarura lokale ose si korrespondentë për media nacionale ose më të mëdha me qendër në Shkup.

Duhet të theksohet se rolet profesionale në nivel lokal rrallë përvijohen qartë. Gjysma e të intervistuarve lokalë, **8 nga 16, njëkohësisht kryejnë role redaktuese**, duke përfshirë redaktorët ose kryeredaktorët, dhe **6 janë gjithashtu pronarë ose bashkëpronarë të mediave të tyre**. Ky përqendrim i përgjegjësive pasqyron realitetet strukturore të gazetarisë lokale, ku ekipe të vogla dhe resurse të kufizuara kërkojnë që gazetarët të kombinojnë raportimin, redaktimin, menaxhimin dhe shpesh detyrat teknike në kuadër të një roli të vetëm. Në këtë kontekst, gazetaria hulumtuese mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar – shpesh e ndërlidhur me pushtetin lokal, gjyqësorin, çështjet lokale, dhunën me bazë gjinore ose punësimin partiak – nuk ekziston si një fushë e veçantë e gazetarisë. Në vend të kësaj, shpesh përplasjet me mbulimin e lajmeve të përditshme.

Së dyti, për të kontekstualizuar gjetjet nga mediat lokale dhe për të mundësuar krahasimin me redaksitë më të mëdha, të centralizuara, **u zhvilluan katër intervista të thella me kryeredaktorët nga mediat me qendër në Shkup**, duke përfshirë tre gra dhe një burrë.

Përveç intervistave individuale, njohuritë nga **gratë gazetare me bazë në Shkup** u mblodhën përmes një punëtorie/diskutimi të lehtësuar, i cili siguroi hapësirë për reflektim kolektiv mbi dinamikën e dhomave të lajmeve, ndarjet gjinore të punës dhe përvojat e ngacmimit në nivelin qëndror. Ndërsa kjo nuk u hartua si një fokus grup formal, diskutimi gjeneroi njohuri të rëndësishme cilësore që plotësojnë të dhënat e intervistës.

Hulumtimi gjithashtu përfshiu një angazhim të kufizuar me **studentë të gazetarisë dhe të rinj të interesuar në media**, të kryer përmes një punëtorie mbi gazetarinë hulumtuese dhe raportimin e interesit publik. Kjo na dha një pasqyrë mbi socializimin e hershëm profesional, rënien e interesit për këtë fushë dhe perceptimet e gazetarisë si një profesion i pasigurt dhe i paqëndrueshëm. Megjithëse nuk janë një grup analitik thelbësor, këto perspektiva theksuan sfidat e gjeneratave të rëndësishme për qëndrueshmërinë e ardhshme të gazetarisë lokale.³⁰

Konsultime me palët e interesuara përkatëse

Për të fituar njohuri mbi perceptimet e palëve të interesuara përkatëse civile dhe institucionale në sferën e medias, ne zhvilluam **4 konsultime me palët e interesuara përkatëse**: (1) konsultim me përfaqësues nga organi rregullator qeveritar – **Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (AAVMU)**, (2) **Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM)**, respektivisht, me një përfaqësues nga organi vetë-rregullues, **Këshilli i nderit**, (3) **Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatik (SPGPM)** dhe (4) rrjeti joformal i udhëhequr nga gratë **EDNAKVA (E BARABARTA)**, që vepron në kuadër të SPGPM.

Përveç kësaj, kemi kryer **4 konsultime me ekspertë** me përvojë gjithëpërfshirëse hulumtuese në lidhje me sferën e medias, duke përfshirë përfaqësues nga **Platforma për gazetari dhe analiza hulumtuese (PINA)**, **Instituti maqedonas për media (IMM)**, **Instituti hulumtues për zhvillim shoqëror (RESIS)** dhe një studiues i pavarur i lidhur me SPGPM.

d. Kufizimet e studimit dhe rrugët për hulumtime të ardhshme

Ndërkohë që ky hulumtim përdor një këndvështrim feminist dhe pjesëmarrës, ai nuk pretendon të kapë plotësisht kompleksitetin ndërsektorial të përvojave të gazetarëve në të gjitha akset e pabarazisë.

Analiza shikon gjininë, gjeografinë (periferi-qendër) dhe moshën si faktorë të spikatur që formojnë pasigurinë dhe marginalizimin profesional në gazetarinë lokale. Megjithatë, për shkak të kufizimeve metodologjike dhe rreziqeve që lidhen me dukshmërinë në komunitetet e vogla, dimensionet e tjera kritike të kryqëzimit, më së

³⁰ Kjo shtjellohet më tej në nënseksionin “Kufizimet metodologjike” më poshtë

shumti **përkatësia etnike, klasa socio-ekonomike dhe aftësia e kufizuar**, mbeten të pa eksploruara sa duhet. Këto dimensione janë veçanërisht të rëndësishme në një kontekst të tillë si Maqedonia e Veriut, ku shtresimi etnik, përjashtimi i bazuar në klasë dhe barrierat e aftësimit vazhdojnë të formësojnë qasjen në punësim, mbrojtjen institucionale dhe zërin publik.³¹

Mungesa e të dhënave sistematike për këto dimensione nuk pasqyron parëndësinë e tyre, por përkundrazi **heshtjen strukturore dhe cënueshmërinë e shtuar** të gazetarëve të pozicionuar në kryqëzimin e margjinalizimeve të shumëfishta. Prandaj, hulumtimi i ardhshëm do të përfitonte nga qasjet e synuara, të bazuara në besim, të cilat mund të shqyrtojnë në mënyrë të sigurt se si përkatësia etnike, klasa dhe aftësia e kufizuar kryqëzohen me gjininë, moshën dhe lokalitetin për të prodhuar përvoja të diferencuara të rrezikut, përjashtimit dhe qëndrueshmërisë në kuadër të sektorit të medias. Në të njëjtën kohë, procesi i hulumtimit përfshinte angazhim të kufizuar me studentë të gazetarisë dhe të rinj në zonat lokale. Ndërsa ne u angazhuam me të rinjtë përmes shtrirjes së universiteteve dhe punëtorive në bashkëpunim me unionet e studentëve, shumica e të pranishmëve ishin të rinj që nuk janë domosdoshmërisht të angazhuar në sferën e medias dhe me qendër në rajonin qendror. Adresimi i realiteteve të gazetarëve të rinj lokalë ose aspirantë, duke qenë kyç për të ardhmen e gazetarisë lokale dhe lirisë së medias, kërkon hulumtime dhe ndërhyrje të përkushtuara që lidhin edukimin e gazetarisë, median e pavarur dhe ekosistemet lokale të lajmeve përmes praktikës hulumtuese, mentorimit dhe pikave të sigurta të hyrjes për të rinjtë.

Në të njëjtën kohë, procesi i hulumtimit përfshinte **angazhim të kufizuar me studentë të gazetarisë dhe të rinj në zonat lokale**. Ndërsa ne u angazhuam me të rinjtë përmes shtrirjes së universiteteve dhe punëtorive në bashkëpunim me unionet e studentëve, shumica e të pranishmëve ishin të rinj që nuk janë domosdoshmërisht të angazhuar në sferën e medias dhe me qendër në rajonin qendror. Adresimi i realiteteve të gazetarëve të rinj lokalë ose aspirantë, duke qenë kyç për të ardhmen e gazetarisë lokale dhe lirisë së medias, kërkon hulumtime dhe ndërhyrje të përkushtuara që lidhin edukimin e gazetarisë, median e pavarur dhe ekosistemet lokale të lajmeve përmes praktikës hulumtuese, mentorimit dhe pikave të sigurta të hyrjes për të rinjtë.

Së fundi, megjithëse studimi **nuk shqyrton sistematikisht kushtet e mediave dhe punëtorëve teknikë**, ky dallim është i paqartë në nivelin lokal, ku gazetarët kryejnë në mënyrë rutinore detyra teknike, prodhuese dhe shpërndarëse krahas raportimit, duke absorbuar në mënyrë efektive role të shumëfishta në kuadër të një pozicioni të vetëm. Ky rol mbingarkues përkeqëson më tej pasigurinë dhe duhet të adresohet në hulumtimet e ardhshme që do të përipiqen të kapin ekosistemin e medias në tërësi, duke përfshirë ndërvarësitë midis roleve gazetareske, teknike dhe mbështetëse.

³⁰ Komiteti këshillimor për Konventën kornizë për mbrojtjen e pakicave nacionale (ACFC) (2022). "OPINIONI I PESTË PËR MAQEDONINË E VERIUT", Këshilli i Evropës. Marrë nga: <https://tinyurl.com/mw8uf32s> më 15 dhjetor, 2025

KORNIZA LIGJORE



Gazetarët në Maqedoninë e Veriut mbrohen formalisht nga një grup kompleks instrumentesh ligjore ndërkombëtare dhe nacionale që rregullojnë lirinë e shprehjes, të drejtat e punës, rregullimin e medias dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna. Këto korniza krijojnë garanci të rëndësishme normative për pavarësinë, sigurinë dhe barazinë gazetareske dhe formojnë një pjesë kyçe të detyrimeve të shtetit sipas ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe procesit të tij të pranimit në BE. Megjithatë, ekzistenca e mbrojtjeve ligjore nuk siguron në vetvete mbrojtje efektive në praktikë. Siç tregon ky studim, boshllëqet në zbatimin, dhe koordinimin institucional, veçanërisht në nivel lokal, formësojnë ndjeshëm mënyrën se si këto korniza përjetohen nga gazetarët në punën e tyre të përditshme. Përkundër këtij sfondi, pjesët e mëposhtme përshkruajnë disa nga kornizat kryesore ligjore ndërkombëtare dhe nacionale të rëndësishme për të drejtat dhe sigurinë e gazetarëve, duke theksuar distancën që shpesh vazhdon midis angazhimeve ligjore zyrtare dhe realizimit të tyre praktik.

Korniza ndërkombëtare

Ligji evropian për lirinë e medias (EMFA), që hyn në fuqi në gusht të vitit 2025, paraqet një zhvillim kryesor për të siguruar transparencën dhe llogaridhënien në hapësirën digjitale dhe të drejtën për të pasur qasje në një shumicë të përmbajtjes së pavarur redaktuese të medias.³² Ai mbron vendimmarrjen redaktuese nga ndërhyrjet e jashtme dhe i jep përparësi transparencës së pronësisë së medias.³³ Përputhja midis legjislacionit nacional dhe EMFA është thelbësore për rrugën e pranimit të vendit në BE dhe do të shërbejë për të mbrojtur pluralizmin e medias dhe do t'u mundësojë gazetarëve të raportojnë mbi korrupsionin dhe krimin e organizuar pa u përballur me pengesa dhe kërcënime për sigurinë e tyre personale dhe pozicionin profesional.

Përveç kësaj, **Rekomandimi i Komisionit të BE-së 2021/1534** vendos një bazë ligjore gjithëpërfshirëse për mbrojtjen, sigurinë dhe fuqizimin e gazetarëve dhe profesionistëve të medias.³⁴ Në nenin 20, duke pasur parasysh rrezikun e lartë të kërcënimeve fizike dhe sulmeve kundër gazetarëve hulumtues dhe gazetarëve ose profesionistëve të mediave që punojnë në rastet që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe korrupsionin, Rekomandimi bën thirrje për përforcimin e masave mbrojtëse për të garantuar sigurinë e tyre.

Ai gjithashtu mbulon çështje të diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore. Angazhimet e ndjeshme gjinore janë të qarta në dritën e harmonizimit të tij me **Strategjinë e BE-së për barazinë gjinore (2020-2025)** dhe **Planin për veprim gjinor III të BE-së**. Në nenin 3, Rekomandimi pranon numrin në rritje të dhunës me bazë gjinore drejtuar grave gazetareske dhe u bën thirrje institucioneve publike të sigurojnë një mjedis të përshtatshëm ligjor, duke i marrë seriozisht kërcënimet penale ndaj gazetarëve me një hetim, ndjekje

³² ECPMF (2025). "EMFA në fuqi: Një epokë e re për lirinë e medias në BE." [online] Qendra evropiane për lirinë e shtypit dhe medias. Marrë nga: <https://tinyurl.com/yhfne858> më 15 dhjetor 2025.

³³ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (2024). "Krijimi i një kornize të përbashkët për shërbimet e medias në tregun e brendshëm dhe ndryshimi i Direktivës 2010/13/BE (Ligji evropian për lirinë e medias)." Marrë nga <https://tinyurl.com/3hap3hpr> më 15 dhjetor 2025.

³⁴ Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian (2021). "Rekomandimi i Komisionit (BE) 2021/1534 i 16 shtatorit 2021 për sigurimin e mbrojtjes, sigurisë dhe fuqizimit të gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias në Bashkimin Evropian". EUR LEX. Marrë nga: <https://tinyurl.com/bdef4p8p> më 15 dhjetor, 2025.

dhe sanksione të përshtatshme. Lidhur me dispozitat në lidhje me barazinë gjinore në vendin e punës në media, siç thuhet në nenin 28, ajo pranon se gratë vazhdojnë të kenë përfaqësim të ulët në sektorin e medias në pozita menaxheriale dhe ekzekutive të larta. Ai rekomandon masa për të siguruar mundësi të barabarta pune dhe një mjedis pune të sigurt dhe gjithëpërfshirës për mediat.³⁵

Plani i veprimit gjinor III i BE-së në vetvete paraqet një agjendë për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në të gjithë veprimin e jashtëm të BE-së. Ai përmend gazetarët si gra në jetën publike që shpesh “i nënshtrohen dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë forma të ndryshme të dhunës në internet dhe madje edhe femicid, në mes të tkurrjes së hapësirës qytetare”.³⁶ Në përputhje me këtë, ai inkurajon veprimin e BE-së të përqendruar në promovimin e një mjedisi të sigurt (online) për gratë gazetare dhe fuqizimin e grave si prodhuese të informacioneve, dhe si sipërmarrëse dhe vendimmarrëse në sektorin e medias.³⁷

dokumento **sulme të përsëritura fizike ndaj gazetarëve**, duke përfshirë sulme nga forcat e sigurisë dhe mbështetësit pro-qeveritarë, si pjesë e përkeqësimit të përgjithshëm dhe mjedisit të rrezikshëm të shtypit.⁸² Një nga indikatorët më të qartë të presionit mbi mediat ka qenë **rritja dramatike, dhe luhatja pasuese, në paditë për shpifje** ndaj gazetarëve, siç dokumentohet nga Shoqata e gazetarëve të Maqedonisë (SHGM).⁸³ Vetëm në vitin 2012, pas dekriminalizimit të shpifjes, janë ngritur afërsisht 330 padi civile kundër gazetarëve dhe mediave.⁸⁴ Deri në vitin 2017, ky numër kishte rënë në 39 raste, duke rënë më tej në 33 në vitin 2020 dhe 20 raste në vitin 2021, përpara se të rritej përsëri në 54 raste në vitin 2022 dhe më pas të binte në vetëm 15 raste në vitin 2024. Trendi i përgjithshëm rënës i atribuohet kryesisht ndryshimeve në Ligjin për përgjegjësinë civile për fyerje dhe shpifje, i cili hyri në fuqi në vitin 2024 dhe paraqiti pragje më të ulëta të kompensimit dhe masa mbrojtëse shtesë për punën gazetareske. Megjithatë, pavarësisht zvogëlimit të numrit të përgjithshëm të rasteve të shpifjes, paditë strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPPs) janë përdorur gjithnjë e më shumë vitet e fundit si një mjet për të frikësuar dhe heshtur gazetarët që raportojnë për çështje me interes publik.

Gazetarët e vjetër e kujtojnë këtë si një kohë kur “i gjithë sistemi po punonte kundër mediave” dhe e kanë shumë të qartë se klima ka ndryshuar dhe “ata nuk janë më nën çizmen e sistemit”, siç pretendon një kryeredaktore femër nga një medium i madh nacional:

“Duhet të them se **në 6-7 vitet e fundit, klima ka ndryshuar në mënyrë drastike dhe presioni është ulur**. Është një gjë kur një individ që ndihet i prekur përpiqet të ndikojë në media në mënyrë që historia e tyre të duket ndryshe ose të mos publikohet, dhe një gjë tjetër kur i gjithë sistemi po punon kundër jush, **duke ju vendosur fjalë për fjalë nën çizmen e tij**. Në vitet e fundit **mediat kanë filluar të rifitojnë vendin dhe rolin e tyre në shoqëri**; jo të gjithë gjykatësit dhe prokurorët janë kundër tyre dhe qeveria nuk është në luftë me ta. Pra, jemi në një lloj rruge që ec përpara, edhe pse situata është larg nga e niveli i shkëlqyeshëm.”

Ndërsa **dy vitet e fundit kanë sjellë përmirësime të matshme**, veçanërisht në zvogëlimin e presionit sistematik të shtetit, brishtësia strukturore e sektorit të medias do të thotë që **liritë e fituara mund të gërryhen shpejt**, veçanërisht në kohën e ndërrimeve politike (globale dhe nacionale). Vitin e kaluar solli një ndryshim të qeverisë nga një parti e qendrës së majtë në një parti të qendrës së djathtë, një kthesë e ngjarjeve që, së bashku me debatet e vazhdueshme mbi integrimin në BE, marrëdhëniet me shtetet fqinje dhe zhvendosjen e dinamikës së partive, kontribuan në një klimë të tensionit të pashmangshme u përhapën në sferën e medias, ku akuzat për ndërhyrje politike, raportim selektiv dhe presion të ripërtërirë mbi rreshtat e redaktorëve u bënë gjithnjë e më të zakonshme.⁸⁵

⁸² RSF (2017). “Gazetarët vazhdimisht sulmohen në krizën politike maqedonase”. [online] Marrë nga: <https://tinyurl.com/4und5zvs> në 15 dhjetor, 2025

⁸³ Shih në Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska, V. (2023). *Maqedonia e Veriut: Treguesit për shkallën e lirisë së medias dhe sigurinë e gazetarëve 2022*. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/3farhzw> dhe Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksi për sigurinë e gazetarëve 2024* [„Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на безбедноста на новинарите 2024”]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpqtuu>.

⁸⁴ Ibid.

⁸⁵ Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksi për sigurinë e gazetarëve 2024* [„Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на

Në të njëjtën kohë, ekonomia vendase luftoi nën efektet e kombinuara të inflacionit global, çmimeve të larta të energjisë dhe rënies së stabilitetit të tregut. Mediat ishin ndër sektorët më të goditur: tkurrja e tregjeve të reklamave, migrimi i buxheteve të marketingut në platformat digjitale dhe rritja e shpenzimeve të punës bënë që shumë redaksi të përballen me pasiguri të rëndë financiare. Buxhetet për raportimin investigativ u zvogëluan, kushtet socio-ekonomike të gazetarëve u përkeqësuan dhe shumë media u bënë edhe më të varura nga financimi i jashtëm për të mbijetuar. **Kjo brishtësi ekonomike krijoi terren pjellor për ndikimin politik dhe të korporatave, duke e vënë autonominë e redaksisë nën një tendosje shtesë.**⁸⁶

Ndërsa këto ndërrime tashmë kanë filluar të riformësojnë klimën e mediave nacionale, efektet janë veçanërisht akute në redaksitë lokale, ku ekuilibri i pushtetit është shumë më i brishtë. Intervistat zbulojnë se **ndryshimet në udhëheqjen politike shpesh pasqyrohen pothuajse menjëherë në ndryshimet në politikën e redaksisë** – ndonjëherë pa shpjegime dhe shpesh përmes formave delikate të kufizimit të brendshëm. Një gazetar vendase përshkroi se si, pas ndryshimit të fundit të qeverisë, hetimet serioze nuk “kalojnë” më, pasi **redaktorët kërkojnë histori më afirmative ose jo kritike ose kufizojnë dukshmërinë e temave të ndjeshme** duke i mbajtur ato larg mediave sociale:

“Ata vendosin nëse një temë e caktuar nuk do të transmetohet, ose do të transmetohet vetëm në lajme, por jo në Facebook ose Instagram, ose në ndonjë media sociale ku ne e dimë se lajmet lexohen në të vërtetë. Sinqerisht, deri rreth një vit më parë gjithçka miratohej lehtësisht dhe nuk kishim probleme... Unë kam punuar në këtë media për më shumë se shtatë vjet. **As unë dhe as kolegët e mi nuk jemi mësuar të punojmë në këtë mënyrë.**”

Të intervistuarit raportuan vazhdimisht se çështjet e “mbulimit me sheqer respektivisht ëmbëlsimit” në nivel lokal janë bërë gjithnjë e më shumë normë. Siç shpjegoi një gazetar, kur lindin probleme, raportimi shpesh zhvendoset drejt minimizimit të implikimeve të tyre dhe theksimit të “proaktivitetit” institucional, me rrëfime të tilla si “ata po punojnë në të” ose “është kujdesur për të”.

“Një gazetar tjetër vuri në dukje se megjithëse gazetarët lokalë pritet zyrtarisht të qëndrojnë pranë qytetarëve dhe të shqyrtojnë me kujdes dështimet politike, këto pritshmëri janë ngushtuar në praktikë. Duke reflektuar mbi ndryshimet e fundit, ajo vërejt se “nuk është më si më parë; nuk i kishim këto kufizime”, duke shtuar se atmosfera aktuale “u kujton atyre periudhën kur Gruevski ishte në pushtet - ata po përmbahen, **ata kanë frikë nga diçka**”. Intervistat gjithashtu theksuan se kjo ndjenjë e kufizimit është veçanërisht akute në tregjet e vogla, lokale të mediave, kuk gazetarët shpesh varen shumë nga rrjetet personale dhe reputacioni për punësim të vazhdueshëm, duke rritur rreziqet që lidhen me raportimin kritik.

Një nga shembujt më të qartë se si janë materializuar këto presione politike dhe ekonomike gjendet në rregullimin e reklamave publike. Me **shfuqizimin e nenit 102 të vitit 2024**, i cili më parë kufizonte institucionet shtetërore, ndërmarrjet publike, komunat dhe organet e tjera publike nga financimi i mediave private, sistemi është

безбедноста на новинарите 2024”]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpptuu> më 15 dhjetor 2025.

⁸⁶ Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksin për sigurinë e gazetarëve 2024* [„Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на безбедноста на новинарите 2024”]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpptuu> më 15 dhjetor 2025.

bërë përsëri i cënuar nga praktikat e shpenzimeve të errëta dhe levat politike. Ndërsa mbështetësit e mbrojtën amendamentin si një shpëtim financiar të domosdoshëm për median në vështirësi, shoqatat e gazetarëve dhe ekspertët e medias paralajmëruan se, pa një procedurë të qartë dhe transparente për ndarjen e mjeteve publike, ndryshimi përbën një **kërcënim serioz për objektivitetin e medias**.⁸⁷

Zbrazëtirat strukturore në mjedisin rregullator kanë qenë veçanërisht të dukshme në nivel lokal. Pa një procedurë të unifikuar se si komunat duhet të zbatojnë fushata me interes publik, **fushatat mund të shndërrohen lehtësisht në nxitës për ndikim politik**, siç kanë paralajmëruar raportet e fundit. Që nga shfuqizimi, pak komuna kanë publikuar informacion të detajuar mbi kontratat e nënshkuara, mjetet e shpenzuara ose efektet e fushatave të kryera, gjë që zvogëlon mundësinë për mbikëqyrje publike.⁸⁸

Për më tepër, mungesa e transparencës ka mundësuar **prej kohësh përhapjen e mediave (lokale) në internet** – pronësia e të cilave rrallë dihet ose zbulohet – të krijuara pak para zgjedhjeve, të krijuara kryesisht për të hyrë në financimin e fushatës publike.⁸⁹ Në përgjigje të shqetësimeve afatgjata, ndryshimet në ligjin e medias të miratuar në mars të vitit 2024 synojnë të adresojnë disa nga këto çështje strukturore duke futur një **regjistër vullnetar të mediave online**. Vetëm ato portale që vendosin të regjistrohen në ASHMAA do të kenë të drejtë të marrin mjete publike dhe do t'u kërkohej të përmbushin detyrimet themelore të transparencës në lidhje me strukturën e redaksisë, financimin dhe pronësinë. Megjithatë, siç vuri në dukje përfaqësuesi i ASHMAA-së që konsultuam, ende nuk ka një mekanizëm efektiv për të monitoruar nëse portalet online janë në përputhje me kërkesat e raportimit të balancuar.

Për më tepër, zbatimi i regjistrimit online kishte disa të meta serioze kur bëhet fjalë për median lokale. Kërkesat fillestare që mediat online të punësojnë minimumi tre gazetarë për t'u regjistruar si media u reduktuan më vonë në dy pas presionit nga mediat lokale, shumë prej të cilave veprojnë me staf minimal dhe resurse të kufizuara. Kjo mbikëqyrje përfshin se si **përpjekjet rregullatore, kur projektohen pa ndjeshmëri ndaj konteksteve lokale, rrezikojnë të krijojnë tendosje shtesë në redaksitë lokale tashmë të pasigurta, në vend që t'i mbrojnë ato**.

Kjo klimë e varësisë së medias dhe shtetit, siç tregon hulumtimi, zbeh kufijtë midis politikës dhe medias, duke i lejuar partitë politike të kanalizojnë mjetet shtetërore në media miqësore për fushatën, duke përforcuar modelet e klientelizmit, korrupsionit dhe ndikimit të padrejtë mbi gazetarinë e pavarur.⁹⁰ Një monitorim i pavarur i 30 portaleve të lajmeve në internet gjatë zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024 tregoi se mediat e përzgjedhura rastësisht intensifikuan ndjeshëm mbulimin e tyre të aktiviteteve të partisë, me ato që publikuan vëllimin më të madh të raporteve lidhur me zgjedhjet që shfaqnin njëanshmëri të qartë në favor të kandidatëve specifikë.⁹¹

⁸⁷ Ibid.

⁸⁸ Sanev A. & Jovanovska M. (2025). *Analizë: Transparenca e njësisë të vetëqeverisjes lokale për shpenzimin e resurseve publike në media*. [“Транспарентноста на единиците на локалната самоуправа за трошееето јавни средства во медиумите (анализа)”]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/69vame3p> më 15 dhjetor 2025

⁸⁹ Rizaov, G., Richliev Z. & Epis, S. (2025). *Raporti në hije mbi lirinë e medias në Maqedoninë e Veriut. Fondacioni Metamorfozis & Osservatorio Balcani Caucaso Transeuropa*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/5akyjzwt> më 15 dhjetor 2025

⁹⁰ MALKI, S. C. (2017). “Korrupsioni dhe përqendrimi i medias: një analizë e të dhënave të panelit” (Dokumenti nr. 81073 i MPRA-së). Arkivi personal RePEc i Mynihut. Marrë nga: <https://mpra.ub.uni-muenchen.de/81073> më 15 dhjetor 2025

⁹¹ Gjigal, S., Bejkova B. & Georgievski, D. (2024). *Monitorimi i mbulimit të portaleve të lajmeve në internet të zgjedhjeve parlamentare 2024 në Maqedoninë e Veriut*. Fondacioni për Internet dhe Shoqëri “Metamorfozis”. Marrë nga: <https://tinyurl.com/yc3f54dy> më 15 dhjetor 2025

Këto dinamika nuk janë të reja. Në të kaluarën, reklamimi shtetëror konsiderohej gjerësisht si një nga mjetet më të fuqishme për kontrollin e mediave, gjë që e bën rishfaqjen e praktikave që dikur kishin kompromentuar thellësisht lirinë e medias problematike për ekspertët dhe shoqatat e gazetarëve.⁹² **Në vend që të shërbejnë si pika kontrolli të pavarura, media rrezikon të bëhet jehonë për elitat politike dhe ekonomike.** Kur varësitë e tilla financiare dhe politike futen në sistemin e medias, ato gjithashtu formësojnë mjedisin në të cilin veprojnë gazetarët.⁹³

Raportimi mbi korrupsionin ose krimin e organizuar mund të shkaktojë **hakmarrje dhe presione**, një dinamikë veçanërisht akute në media më të vogla në nivel lokal. Ndryshe nga mediat me burime të mira me qendër në Shkup, mediat lokale zakonisht veprojnë me shumë më pak resurse financiare, njerëzore dhe teknike, duke i bërë ato shumë më të varura nga reklamat ose subvencionet shtetërore, me aktorë të fuqishëm si organet qeveritare ose sponsorët privatë të biznesit pastaj kanë një rol në mënyrën se si ato portretizohen. Kjo krijon një mjedis ku **raportimi kritik mbart pasoja të menjëhershme ekonomike**. Një grua gazetare dhe kryeredaktore e medias lokale e tha troç:

“Jemi të detyruar, për hir të mbijetesës ekonomike të medias, **të raportojmë në mënyrë afirmative** dhe, aq sa nuk dua ta pranoj, **të veprojmë si krah i zgjatur i pushtetit lokal**. Një pjesë e madhe e tirazhit tonë të shtypur blihet nga institucione ose kompani të lidhura me dikë. Askush nuk dëshiron të jetë një parapagues vjetor dhe më pas të lexojë se po kritikohet. Që nga fillimi, **ne shtyhemi drejt lavdërimit**; gjithçka tjetër futet nën qilim. Elementi ekonomik krijon një vetëcensurë të madhe.”

Kështu, varësia ekonomike i shtyn mediat lokale të shndërrohen në “rojtare të bindur” në vend të “rojtareve të interesit publik”, duke ua pamundësuar ofrimin e një raportimi të pavarur dhe objektiv. Të intervistuarit e lidhën këtë dinamikë me zakonet e vetëcensurës, ose siç shpjegoi njëri prej tyre:

“Kam kontrata vjetore me tre ndërmarrje publike: ujësjellësi, shërbime komunale dhe mirëmbajtje rrugore. Shumat janë të vogla. Por ato reklama bëhen një frenim: në momentin që unë publikoj diçka për plehrat, papastërtitë, çdo gjë që njerëzit duan të shohin të theksuar dhe të kritikuar, [ndërmarrjet] më telefonojnë dhe thonë, ‘Pse po na kritikon? Po bëjmë më të mirën tonë’.”

Një gazetare shpjegoi se roli i saj “natyrisht” shtrihet edhe në marketing: ajo duhet të kërkojë rregullisht reklama nga bizneset, megjithëse jo nga ato lokale, pasi raportimi i saj kritik i ka ofenduar pothuajse të gjithë (“Unë kam shkruar kundër çdo biznesi në qytet”). Në vend të kësaj, asaj i thuhet të kërkojë kompani të mëdha nacionale. Fatkeqësisht, rasti i saj nuk është një rast i izoluar, pasi shumica e të intervistuarve tanë ndanë shqetësimet e saj.

⁹² Tuneva, M. (2023). *Midis sfidave dhe zgjidhjeve: Një udhëzues për integritetin e medias në Maqedoninë e Veriut*. SHGM & UNDP. Marrë nga: <https://tinyurl.com/2s5vybzf> më 15 dhjetor 2025.

⁹³ BIRN. (NA). “Varësia financiare: Klientelizmi si modus operandi”. Monitorimi i pronësisë së mediave në Maqedoninë e Veriut 2023. Marrë nga: <https://tinyurl.com/55wzxmjt> më 15 dhjetor, 2025.

Dezinformimi, përmbajtja “mediatike” e PR dhe vakumi i mediave lokale

Pasiguria financiare dhe mbështetja në reklamat (politike), të kombinuara me frikën e heshtjes nëse kritikoni ata që ju paguajnë, kanë shkaktuar shtrembërime shqetësuese në ekosistemet e mediave lokale.

Së pari, vakumi i krijuar nga mediat e dobësuara profesionale ka hapur hapësirë për **individët me pak ose aspak trajnim gazetarie dhe shpesh me lidhje të ngushta me qendrat e pushtetit për të kapur tregun e reklamave dhe për t'u paraqitur si media**. Të intervistuarit vunë në dukje rastet kur disa zyrtarë publikë hapin portale online dhe tërheqin pjesën më të madhe të reklamave lokale për shkak të afërsisë së tyre institucionale. Një gazetarë grua përshkroi një shembull veçanërisht të mrekullueshëm të një oficeri policie nga një qytet i shquar në Maqedoninë e Veriut që drejton një portal vetë dhe merr shumicën e reklamave lokale thjesht sepse bizneset dhe institucionet e shohin atë si zgjedhjen “më të sigurt” për të bërë koalicion me të. Praktika të tilla jo vetëm që devijojnë resurset e pakta larg gazetarisë së vërtetë, por gjithashtu zbehin kufijtë midis institucionit publik, fitimit privat dhe ndikimit politik, duke **gërryer më tej besimin e publikut**.

Së dyti, brishtësia ekonomike e redaksive lokale ka nxitur atë që shumë të intervistuar e quajtën **“gazetari në Facebook”**, respektivisht një zhvendosje nga puna hulumtuese drejt ripostimit të **njoftimeve për shtyp, transmetimit të drejtpërdrejtë të ngjarjeve politike dhe amplifikimit të përmbajtjes PR**. Në vend që të bëjnë pyetje, gazetarët pritët të “ndjekin” zyrtarët lokalë që shkojnë në punën e tyre të përditshme, duke dokumentuar çdo hap për dukshmërinë e mediave sociale. Siç u shpreh një i intervistuar:

“Kjo është mjaft e re. Në të kaluarën, gjatë njoftimeve për shtyp, ne i ballafaqim politikanët me pyetjet tona. Tani është e gjitha një shfaqje qesharake PR – politikanët flasin, dhe të **ashtuquajturit gazetarë thjesht mbajnë mikrofoni** dhe transmetojnë në platformë fjalën e tyre.”

Një prirje paralele zbeh më tej kufijtë e informacionit të besueshëm: **rritja e influencësve (lokale) që gjithnjë e më shumë funksionojnë si burime jozyrtare të lajmeve**. Të intervistuarit vunë në dukje se këto shifra – shpesh pa ndonjë trajnim gazetarie, detyrime etike ose mbikëqyrje të redaksisë – megjithatë tërheqin audiencën të mëdha dhe marrin promovime të paguara nga aktorët politikë ose bizneset lokale. Përmbajtja e tyre, e përshtatur si përditësime të komunitetit ose “informacione të brendshme”, në fakt është formuar nga interesa të errëta dhe besnikëri personale. Kjo dinamikë jo vetëm që lë mënjanë gazetarët profesionistë, por edhe ngatërron audiencat, të cilët përpiqen të bëjnë dallimin midis raportimit të pavarur, përmbajtjes së sponsorizuar dhe propagandës së plotë.

Ndërsa dezinformimi dhe rrëfimet anti-BE ose anti-perëndimore shpesh analizohen në nivel nacional, efektet e tyre ndjehen thellë dhe shfrytëzohen në mënyrë strategjike, në nivel lokal.⁹⁴ Erozioni i gazetarisë lokale krijon një **boshllëk informacioni në të cilin**

⁹⁴ Instituti për dialog strategjik (2024). “Monitorimi i fushatave të ndikimit dhe dezinformimit në Ballkanin Perëndimor

dezinformimi qarkullon me pak rezistencë, veçanërisht në komunitetet me qasje të kufizuar në burime të pavarura dhe të besuara të lajmeve. Në kontekste të tilla, portalet e rreshtuara politikisht, influencuesit dhe mediat e errëta në internet janë në gjendje të paraqesin në kornizë korrupsionin dhe interesin publik përmes narrativave polarizuese që minojnë besimin në institucionet demokratike dhe mediat e pavarura. Si rezultat, dezinformimi nuk vepron si një kërcënim paralel për lirinë e medias, por si një pjesë integrale e të njëjtit ekosistem që dobëson pavarësinë e redaksisë dhe shtrembëron debatin publik. Kjo rrit rreziqet me të cilat përballen gazetarët që sfidojnë strukturat dominuese të pushtetit, veçanërisht në nivel lokal.

Përtej këtyre ndërrimeve në praktikë, të intervistuarit në mënyrë të përsëritur vunë në dukje mungesën e masave mbrojtëse strukturore që do të mbronin pavarësinë e redaksisë. **Maqedonisë së Veriut ende i mungon një Fond për pluralizmin e medias** – një mekanizëm i pavarur i krijuar për të mbështetur përmbajtjen me interes publik dhe për të zvogëluar mbështetjen e mediave lokale në reklamën politike ose klienteliste. Ndërsa mbështetja me grante mund të sigurojë resurse thelbësore për gazetarinë lokale, financimi i tillë shpesh është i paqëndrueshëm dhe i pamjaftueshëm. Shkurtime të fundit, të tilla si ndërprerja e mbështetjes së USAID-it, nxjerrin në pah pasigurinë e këtij modeli. Gazetarët u ankuan në intervista se konkurrenca për resurse të kufizuara ka tendencë të favorizojë mediat e mirë-krijuara, të bazuara në kapital, ndërsa mediave lokale u mungon koha dhe kapaciteti për të përgatitur aplikime të gjëra për grante.

Në vend të kësaj, ata shprehën mbështetje të fortë për krijimin e një fondi autonom që do të siguronte financim transparent, të bazuar në meritë, të izoluar nga ndikimi politik lokal. Ideja ka qarkulluar për vite me radhë,⁹⁵ por asnjë fond i tillë nuk është krijuar ende, duke i lënë mediat lokale të ekspozuara ndaj të njëjtave presione që dikur mundësonin kapjen e gjerë të shtetit. Kështu, shqetësimi në rritje midis gazetarëve lokalë që intervistua ishte se **gazetaria lokale me të vërtetë e pavarur po rrezikon gjithnjë e më shumë të zhduket krejtësisht**. Një kryeredaktore grua paralajmëroi se:

“Pa ndryshim sistemor, çdo gjë e pavarur, ose që tregon shenja pavarësie, do të zbehet ngadalë. Shumë shpejt mund ta gjejmë brendësinë e shtetit të zbrazët, me gjithçka të përqendruar në mediat nacionale.”

Ajo që është në rrezik nuk është vetëm mbijetesa e mediave lokale, por e drejta e publikut për informacion të besueshëm dhe të pavarur për vendet ku ata jetojnë.

(MEDIWEB)”, ISD. Marrë nga: <https://tinyurl.com/mtduv95s> më 18 dhjetor 2025

⁹⁵ Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksin për sigurinë e gazetarëve 2024* [„Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на безбедноста на новинарите 2024”]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpptuu> më 15 dhjetor 2025

Barrierat strukturore, taktikat e frikësimit dhe dhuna (me bazë gjinore)

Pavarësisht realitetit të ashpër të shtytjes përmes resurseve të kufizuara, presionit politik dhe zvogëlimit të qasjes në informacion, shumë gazetarë lokalë vazhdojnë të këmbëngulin në raportimin e tyre kritik, respektivisht për të monitoruar dhe raportuar mbi sjelljen e zyrtarëve publikë, mbi performancën e qeverisë dhe shkeljet e veçanta, në përpjekje për t'i bërë qytetarët të vetëdijshëm dhe për t'i nxitur vendimmarrësit të ndër marrin veprime – megjithatë puna e tyre shpesh vjen me një çmim personal. Ata që guxojnë të raportojnë në mënyrë kritike përballen me një kombinim të pengesave strukturore, transparencës institucionale, frikësimit të drejtpërdrejtë dhe barrierave gjinore. Dëshmitë e tyre zbulojnë një mjedis mediatik të shënuar nga rezistenca e vazhdueshme ndaj frikës, e kombinuar me kujdes dhe një zhvendosje graduale drejt vetëcensurës.

Qasje e kufizuar në informacione

Të intervistuarit theksuan në mënyrë të përsëritur se **qasja në informacione luhetet në varësi të momentit politik**. Disa përshkruan një model: gjatë tranzicionit të pushtetit, institucionet duken më të gatshme të flasin – zyrtarët e sapoemëruar janë të etur të ekspozojnë mangësitë e paraardhësve të tyre. Por sa më gjatë që një administratë të qëndrojë në pushtet, aq më të mbyllura dhe më mosbesuese bëhen institucionet. Një gazetar vuri në dukje se me ardhjen e një qeverie të re, “**gjithçka ngadalësohet**”: kufizimet shtrëngohen, nëpunësit civilë bëhen të frikësuar dhe kanalet e komunikimit tkurren.

Megjithëse Ligji për qasje të lirë në informata të karakterit publik u ndryshua kohët e fundit për të garantuar zyrtarisht një afat 20-ditor që institucionet të përgjigjen, në vend të periudhës së mëparshme 30-ditore, gazetarët përshkruan një realitet shumë të ndryshëm.⁹⁶ Kërkesat refuzohen në mënyrë rutine me përgjigje formulare të tilla si “**ne po punojmë për rastin tuaj**”, të përsëritura për një kohë të pacaktuar. Një i intervistuar e përmbledhi problemin në mënyrë të përmbledhur:

“Për shumë zyrtarë, ligji thjesht nuk ekziston. Ekziston vetëm një rregull – ky informacion do të jepet, ose nuk do të jepet. Nëse ata vendosin ta japin, do ta marrësh brenda një dite. Nëse jo, nuk do ta marrësh kurrë. Ata do t’ju dërgojnë nga institucioni në institucion derisa të hiqni dorë.”

Gjykatat përshkruhen si më të errëta, me degët lokale të ministrive që shpesh presin miratimin nga institucionet qëndrore para se të japin ndonjë informacion. Pavarësisht përmirësimeve legjislativë, qasja mbetet e ngadaltë, jokonsistente dhe e varur nga diskrecioni politik.

⁹⁶ Petrushevska, D. (2024) “Pengesa të shumta dhe barriera në rrugën drejt qasjes së lirë në informacione” [“Бројни препреки и сопки на патот кон слободен пристап до информации“]. [online] PINA. Marrë nga: <https://tinyurl.com/3yr3kdn6> më 15 dhjetor 2025

Për gratë gazetare, **qasja formësohet gjithashtu nga rrjetet joformale, gjinore**. Disa prej tyre vunë në dukje se informacionet vendimtare shkëmbehen në hapësirat sociale të dominuara nga meshkujt, siç janë kafenetë lokale, mbledhjet e natës vonë në bare ose ‘kafenetë’ ose qarqet gjysmë-private nga të cilat gratë shpesh përjashtohen. Siç e shpjegoi qartë një gazetare grua:

“Në këtë vend, gjërat zgjidhen në ‘kafene’. Burrat gazetarë kanë qasje më të gjerë në këto qarqe. Si grua, nuk mund të shkoj dhe të ulem me ta. Ata do të më shikojnë prej anash. Por këtu formohen miqësitë, ku rrjedh informacioni.”

Redaktorët gjithashtu pranuan se disa histori me rrezik të lartë shpesh u jepe gazetarëve meshkuj, jo për shkak të dyshimit në kompetencën e grave, por për shkak të shqetësimit për sigurinë e tyre. Megjithatë, kjo **logjikë “mbrojtëse”**, edhe kur është me qëllim të mirë, mbart rrezikun e përforcimit të qasjes së pabarabartë në mundësi dhe **maskon në mënyrë delikate diskriminimin si kujdes** paralajmërues.

Në të njëjtën kohë, shumë pjesëmarrëse theksuan se gratë gazetare kanë tendencë të jenë më këmbëngulëse, të durueshme dhe të përkushtuara ndaj punës hulumtuese. Çuditërisht, çdo i intervistuar – si burra ashtu edhe gra – i përshkroi gratë gazetare si “më të guximshme” sesa kolegët e tyre meshkuj. Megjithëse askush nuk elaboroi më tej se çfarë nënkupton kjo trimëri, reflektimet e tyre sugjerojnë një formë të rezistencës **të formuar si nga pritjet gjinore ashtu edhe nga realitetet e raportimit në komunitete të vogla, të lidhura ngushtë**.

Një gazetar vuri në dukje se kjo këmbëngulje përkthehet edhe në një lloj tjetër respekti profesional në terren. Duke punuar vetëm, duke mbajtur pajisje vetë dhe duke këmbëngulur për të qenë e pranishme në hapësirat ku gratë nuk priten gjithmonë, ajo përshkroi fitimin e asaj që ajo e quajti një përzierje respekti dhe frike:

“Si gazetare grua, kur më shohin duke punuar vetëm – duke vendosur vetë kamerën, duke dalë në fushë – më respektojnë më shumë. Është një lloj **respekti i lindur nga frikësimi**.”

Kërcënimet dhe ngacmimet e orkestruara

Përtej barrierave institucionale, gazetarët përshkruan një model **sulmesh të orkestruara, si online ashtu edhe offline**, të dizajnuara për të frikësuar dhe heshtur raportimin kritik. Disa media kanë përjetuar **sulme të koordinuara digjitale, vizita të papritura në redaksi dhe telefonata anonime**. Incidente të tilla shpesh çojnë në vetëcensurë: gazetarët braktisin historitë që kanë frikë se mund të përshkallëzohen në hakmarrje personale.

Për shembull, një redaksi lokale mori një mesazh kërcënues nga një institucion lokal duke thënë: “ju tashmë keni dy kartonë të verdhë; kini kujdes që të mos merrni një të kuq”. Gazetarët individualë u etiketuan “gjakpirës”, u akuzuan për paragjykitime politike nga përfaqësuesit e partive lokale ose u vunë në shënjestër përmes fushatave të njollosjes. Një gazetare grua përshkroi një burrë që shfaqej në pragun e derës së saj, ndërsa të tjerët flisnin për të njohurit që pyesnin bashkëshortët ose anëtarët e familjes së tyre për punën e tyre.

Në qytetet më të vogla, **afërsia sociale intensifikon presionin**. Gazetarët theksuan se të gjithë janë të lidhur me aktorët politikë ose institucionalë përmes miqve ose të afërmeve, **duke e bërë neutralitetin të rrezikshëm dhe izolimin të zakonshëm**. Siç u hap një gazetare grua duke thënë:

“Ky është një vend i vogël dhe nuk mund ta përballosh të mendosh përsa u përket miqve. Me pesë persona që takoni në shoqëri, njëri është drejtor, një tjetër punon në një ministri. Ti bllokohesh nga të gjitha anët, kështu që unë përpiqem të mbaj distancën time. Të gjithë miqtë e mi të ngushtë janë nga kryeqyteti.”

Miqësitë me nëpunësit e policisë ose zyrtarët shpesh vijnë me pritshmëri të nënkuptuara për favore në këmbim. Disa gazetarë raportuan presion nga të njohurit duke i nxitur ata të “lënë anash tema të caktuara”, ndërsa të tjerët përballen me **zhvatje delikate**, të tilla si oferta për reklama, lidhje lokale ose mbrojtje politike në këmbim të raportimit të favorshëm. Në mënyrë të ngjashme, një gazetareje iu ofruan para pasi “ata” [me sa duket njerëz që punonin për pushtetin lokal] zbuluan se nëna e saj ishte e sëmurë.

Gjatë intervistave, **kryetarët e komunave shpesh dalin si burime kryesore të presionit ndaj gazetarëve**, siç tregon rasti i mëposhtëm:

“Kishim një problem me kryetarin e mëparshëm të komunës. Një herë, gazeta publikoi raportin e tij për përdorimin e mjeteve publike, dhe më pas lexuam një postim nga një i punësuar i departamentit të financave dhe buxhetit të pushtetit lokal, i cili paraqiste një llogari shumë të ndryshme se ku shkonin paratë në të vërtetë. Vendosi që deklaratën e kryetarit të komunës ta publikojmë në një faqe dhe atë të punësuarit në një faqe tjetër. Pas kësaj, **të gjitha parapagesat tona u anuluan**, ne u goditëm nga një vërshim komentesh armiqësore dhe punëtori u përball me kallëzime penale për keqpërdorim të pozitës dhe rrjedhje të sekreteve publike.”

Në një qytet tjetër, një ish-kryetar komune mbante një “dosje” për çdo gazetar që e kishte “fyer”, pra për këdo që kishte shkruar diçka që ai nuk e pëlqente ose me të cilën nuk pajtohej. Rrjedhimisht, këto taktika frikësimi kanë rezultuar në heshtje të **pavullnetshme**. Siç tha një gazetar në dorëheqje:

“Kolegë nga qytete të tjera në brendësi pajtohen se ka shumë presion në komunitetet lokale dhe mendoj se po largohemi ngadalë nga temat që kanë të bëjnë me pushtetarët lokalë. Duke parë gjendjen e shtetit, dhe duke marrë parasysh gjithçka me të cilën mund të goditesh, si një padi SLAPP, të gjithë jemi vënë në një pozicion ku duhet të matim gjithçka tre herë para se të vendosim. Ende nuk e kam vetëcensuruar shkrimin tim, por mendoj se në një moment do të më duhet ta bëj. **Kjo nuk është koha për të dëshmuar veten; kjo është koha për mbijetesë.**”

Prandaj, edhe gazetarët e aftë dhe të përkushtuar janë të detyruar të lundrojnë në një peizazh ku kujdesi shpesh anashkalon pavarësinë e redaksisë dhe mbijetesë bëhet një shqetësim kryesor. Kjo nuk vjen si befasi, duke gjykuar nga mënyra se si dhuna ndonjëherë përshkallëzohet përtej kërcënimeve. Në një qytet, **automjeti i një pronari**

të medias u dogj pasi ata publikuan një artikull hetues mbi praktikën grabitqare të huadhënies. Megjithatë, edhe përballë sulmeve të tilla të synuara, gazetarët shpesh i normalizojnë këto rreziqe, **duke i trajtuar kërcënimet, ngacmimet dhe dhunën si një aspekt fatkeq, por pothuajse i pashmangshëm i profesionit të tyre.**

Dhuna digjitale (me bazë gjinore) dhe dështimi institucional

Ngjashëm me frikësimin personal ose të tërthortë offline, ngacmimi online i gazetarëve mbetet i përhapur dhe i normalizuar kryesisht në kuadër të profesionit. Gjatë intervistave të kryera për këtë studim, gazetarët përshkruanin vazhdimisht marrjen e komenteve negative të përditshme nën artikujt e tyre ose përmes mesazheve të drejtpërdrejta. Këto sulme shpesh injorohen, jo sepse raportimi i tyre do të kërkonte ta bënin këtë pothuajse çdo ditë. Si rezultat, **kërcënimet për padi, hakmarrja e lidhur me punën dhe abuzimi online perceptohen gjerësisht si pjesë e pashmangshme e punës të gazetarisë.**

Të dhënat e anketës vërtetojnë këto përvoja. Sipas një ankete të vitit 2022 të kryer nga Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve mediatic. (SPGPM), 37.3% e gazetarëve - si gra ashtu edhe burra - raportuan se kishin përjetuar kërcënime, kryesisht në platformat e mediave sociale. Pavarësisht kësaj prevalence, normat e raportimit mbeten jashtëzakonisht të ulëta: vetëm 17.7% e gazetarëve të prekur kontaktuan shoqatat e gazetarëve, ndërsa vetëm 15.9% raportuan incidente në polici, duke reflektuar mosbesim të vazhdueshëm në mekanizmat e mbrojtjes institucionale.

Të dhënat e anketës i mbështesin këto përvoja. Sipas një ankete të vitit 2022 të kryer nga SPGPM, **37.3% e gazetarëve (burra dhe gra) raportuan se kishin përjetuar kërcënime, kryesisht në platformat e mediave sociale.** Pavarësisht kësaj prevalence, normat e raportimit mbeten jashtëzakonisht të ulëta: vetëm 17.7% e gazetarëve të prekur njoftuan shoqatat e gazetarëve, ndërsa vetëm 15.9% raportuan incidente në polici, duke reflektuar mosbesim të vazhdueshëm në mekanizmat e mbrojtjes institucionale – veçanërisht në gjyqësor, polici dhe prokurori publike.⁹⁷ Në një rast të ndarë në intervista, një redaksi mori telefonata kërcënuese për jetën, por policia u tha atyre se do të duhej të prisnin deri në 14 ditë për një zgjidhje, duke i lënë gazetarët të ekspozuar dhe të pambrojtur.

Megjithatë, siç shpjegoi një gazetar vendas, ndërsa sulmet e vogla ose “beninje” shpesh injorohen, format më serioze të frikësimit institucional kërkojnë një qasje tjetër. Ai theksoi rëndësinë e komunikimit të drejtpërdrejtë, me shkrim dhe lënie e një gjurme të dokumentuar kur sulmet vijnë nga institucionet publike, duke vënë në dukje se “nëse një institucion publik ju diskrediton, është e rëndësishme të keni dëshmi me shkrim se diçka ka ndodhur”.

Pavarësisht ekzistencës së ligjeve që synojnë të mbrojnë gazetarët, efektiviteti i tyre mbetet i kufizuar. Hetimet për kërcënimet dhe sulmet shpesh janë të ngadalta, të paplota ose të pasuksesshme, duke krijuar një kulturë të mosndëshkimit që mundëson dhunë të mëtejshme. Edhe kur vendosen sanksione, ato kanë tendencë të jenë të buta

⁹⁷ Bejkova, B. & Dzigal, S. (2022). *Analiza – Siguria dhe situata socio-ekonomike në media: Të veprojme së bashku për respektim më të madh të të drejtave të gazetarëve dhe punëtorëve të medias.* [“Анализа – Безбедносната и социо-економската состојба во медиумите: Со заедничко дејствување до поголемо почитување на правата на новинарите и на медиумските работници”]. SHGM dhe SPGPM Marrë nga: <https://tinyurl.com/3yr3kdn6>, më 15 dhjetor 2025

dhe joproporcionale me ashpërsinë e veprave penale. Megjithëse qeveria ka futur masa të tilla si njësitë e specializuara të policisë dhe prokurorët e caktuar për rastet që përfshijnë punëtorët e medias, këto përpjekje pengohen nga resurset e pamjaftueshme, mungesa e trajnimit, procedurat e ngadalta dhe koordinimi i dobët institucional.⁹⁸

Ndërsa ngacmimet, kërcënimet dhe dhuna digjitale prekin gazetaret gjerësisht, gratë përballen me një shtresë të veçantë dhe intensifikuese të rrezikut. Globalisht, është e dokumentuar mirë që **gratë në gazetari hasin nivele më të larta në mënyrë disproporcionale të ngacmimit profesional dhe personal**, shpesh si një strategji e **heshtjes dhe përjashtimit**.^{99 100 101} Kjo është njohur edhe në nivel lokal, me SHGM-në që publikoi edicionin e tyre të fundit të indeksit të sigurisë me një numër të veçantë mbi sfidat specifike të sigurisë me të cilat përballen gratë gazetare.¹⁰²

Përveç presioneve të raportimit mbi korrupsionin, strukturat e pushtetit dhe çështjet e ndjeshme, **gratë gazetare shpesh janë në shënjestër në mënyrë eksplicite për gjininë e tyre**. Ky model pasqyrohet në nivel lokal, ku sulmet gjinore shpesh përqendrohen më pak në sjelljen profesionale sesa në karakteristikat personale. **Fyerjet, frikësimet dhe sulmet online armatosin pamjen, moralin ose jetën private të tyre në vend të performancës profesionale**. Siç shpjegoi një gazetare grua:

“Gratë gazetare në Facebook u veçuan për veshjen “e papërshtatshme” ose për një jetë “imorale”... Nga ana tjetër, gazetaret meshkuj shpesh inkuadrohen si të korruptuar, zhvaten ose “shantazhohen” ose fyhen si budallenj dhe të paaftë – besueshmëria e tyre dëmtohet ndryshe.”

Ndikimi psikologjik i një ngacmimi të tillë është i rëndësishëm, siç pasqyrohet edhe në intervista. Një gazetare përshkroi marrjen e komenteve armiqësore dhe përgjigjen në nxehtësinë e momentit, duke u penduar për reagimet e saj më pas, por duke mos fshirë postimet. Ajo kujtoi duke qarë me dëshpërim për të parë **punën e saj të zhvlerësuar në një mënyrë kaq çnjerëzore** dhe reflektoi mbi kujdesin që pasoi: “Nëse ata komentojnë kështu, ju ndiheni keq dhe herën tjetër që filloni një histori, mund të jeni më të kujdesshëm. Nuk është se nuk ndikon te ty.”

Vlen të merret parasysh se shumë gra gazetare **raportojnë se janë më të prekura nga komentet e pahijshme online sesa nga kërcënimet e drejtpërdrejta nga figura të fuqishme**, duke reflektuar peshën e përhapur të shqyrtimit publik. Të dhënat sasiore

⁹⁸ Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Maqedonia e Veriut: Indikatorët mbi nivelin e lirisë së medias dhe indeksi për sigurinë e gazetareve 2024* [“Северна Македонија: Индикатори за степенот на слободата на медиумите и Индекс на безбедноста на новинарите 2024”]. SHGM: Shkup. Marrë nga: <https://tinyurl.com/dshpptuu> më 15 dhjetor 2025

⁹⁹ Posetti, J. et al. (2022) *The Chilling: Studimi global i gazetareve për dhunën online ndaj grave. Qendra ndërkombëtare për gazetaret*. Marrë nga: <https://tinyurl.com/47vbvtma> më 15 dhjetor 2025.

¹⁰⁰ Ferrier, M. (2018). “Sulmet dhe ngacmimet - Ndikimi të gazetaret femra dhe raportimi i tyre”. [“Attacks and Harassment - The Impact on Female Journalists and Their Reporting”]. IWMF, TrollBusters. Marrë nga: <https://tinyurl.com/mw654aef> më 15 dhjetor 2025.

¹⁰¹ York, N., Posetti, J., et al. (2025). *Pika e kthesës: Përshkallëzimi drithërues i dhunës në internet ndaj grave në sferën publike*. [“Tipping Point: The Chilling Escalation of Online Violence Against Women in the Public Sphere.”] UN Women Marrë nga: <https://tinyurl.com/3h4hpp7b> më 15 dhjetor 2025. Raporti i fundit, megjithatë, përfshin jo vetëm gazetaret dhe punëtorët e medias, por edhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe aktivistët, respektivisht, gratë në sferën publike, duke zbuluar se 70% e 640 grave që identifikojnë pjesëmarrësit e anketës nga 119 shtete kanë përjetuar dhunë në internet gjatë punës së tyre.

¹⁰² Spirovski, M. & Todorovska-Kostovska V. (2025). *Sfidat dhe zhvillimet: Siguria e grave gazetare në Maqedoninë e Veriut 2024*. [“Предизвици и напредок: Безбедноста на новинарките во Северна Македонија 2024”]. Safejournalists.net. Marrë nga: <https://tinyurl.com/39r4avcs> më 15 dhjetor 2025.

nëvizojnë prevalencën e ngacmimeve online. Një anketë nacionale zbuloi se **81.6% e grave gazetare kishin përjetuar ngacmime online për shkak të punës së tyre**, përsëri, kryesisht në mediat sociale si Facebook. Ngacmimi ishte më së shpeshti i lidhur me botimin e përmbajtjes kritike ndaj institucioneve ose individëve të fuqishëm (56.6%), duke mbuluar tema tradicionalisht “mashkullore” siç janë sportet ose thjesht duke qenë gra në sytë e publikut. Sulmet shpesh përfshinin komente të dhunshme dhe seksiste, postime që përdornin emrat e tyre dhe mesazhe të drejtpërdrejta, me **39% të grave që si rezultat i këtyre veprimeve vetë-censuroheshin**. Ajo që është edhe më alarmante është se **në 16% të rasteve, ngacmimet u zhvendosën nga online në offline**, duke ilustruar një trajektore të qartë online-offline.¹⁰³

Kërcënimet që përfshijnë dhunën seksuale janë një formë veçanërisht alarmante e ngacmimit që synon gratë gazetare, veçanërisht ato që raportojnë për tema të ndjeshme, të tilla si korrupsioni, ose ato me pozicione të dukshme publike për çështje të caktuara sociale. Në shkurt 2025, një rast i dukshëm ndodhi kur Dragan Pavloviç Latas, menaxher i portalit Veçer, postoi një sërë statusesh në mediat sociale që synonin dy gra gazetare (njëra prej tyre kryeredaktore) të Laboratorit të gazetarisë investigative (IRL).¹⁰⁴ Brenda disa orësh, këto postime shkaktuan një valë të gjuhës së urrejtjes dhe thirrjeve për dhunë (kërcënime për përdhunim). Këto kërcënime zakonisht përdoren për të frikësuar gratë gazetare, për të heshtur raportimet e tyre dhe për të minuar besueshmërinë e tyre. Si rezultat, të dy gratë angazhuan sigurim privat për një muaj për të garantuar sigurinë e tyre – një nivel vendimtar i mbrojtjes që shumica e grave gazetare lokale ose të pavarura, veçanërisht ato jashtë Shkupit, nuk do të ishin në gjendje ta përballonin.

Konteksti ndërkombëtar konfirmon modelet e ngacmimit online me bazë gjinore dhe manifestimet e tij fizike. Anketa globale e UNESCO-s dhe Qendrës ndërkombëtare për gazetaret (ICFJ) (2020) zbuloi se 73% e grave gazetare kishin përjetuar dhunë në internet dhe 20% ishin sulmuar offline në lidhje me përvojat e tyre online.¹⁰⁵ Këto gjetje nxjerrin në pah se si mizogjinia armatohet në diskursin publik, veçanërisht në kontekste populiste dhe të ekstremit të djathtë, dhe nënvizon cënueshmërinë e grave gazetare ndaj fushatave të koordinuara të ngacmimit që synojnë heshtjen e raportimit kritik.

